



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË MISIONIT TË VËZHGIMIT TË OSBE /ODIHR, TË INSTITUTIT
DEMOKRATIK AMERIKAN, PARLAMENTIT EVROPIAN DHE AMBASADAVE ITALIANE,
AMERIKANE, SLOVENE PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 00.05.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

KËRKUES: Misioni i Vëzhgimit të OSBE/ODIHR, me adresë Mak Albania Hotel, Sheshi "Italia", Tiranë dhe me përfaqësuese znj. Audrey Glover;

Parlamenti Evropian me seli në Strasburg, Francë dhe me përfaqësuese zj. Roberta Metsola;

Instituti Demokratik Amerikan (NDI), me adresë Rruga "Ismail Qemali", Tiranë dhe me përfaqësuese zj. Ana Kadovic;

Ambasada Italiane, me adresë Rruga "Papa Gjon Pali II", Tiranë, dhe me përfaqësues z. Fabrizio Bucci;

Ambasada Amerikane, me adresë Rruga e Elbasanit, Tiranë dhe me përfaqësuese zj. Yuri Kim;

Ambasada Sllovene, me adresë Rruga "Abdyl Frashëri", Tiranë, dhe me përfaqësues z. Peter Japelj;

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



"Për shqyrtimin e kërkesave të Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR, të Institutit Demokratik Amerikan, Parlamentit Evropian dhe Ambasadave Italiane, Amerikane, Sllovene, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të ambasadave për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

V Ë R E J:

Misioni i Vëzhgimit të OSBE/ODIHR i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 98 (nëntëdhjetë e tetë) përkthyes si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Misioni i Vëzhgimit të OSBE/ODIHR është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Parlamenti Evropian i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 10 (dhjetë) vëzhgues afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Parlamenti Evropian është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor

Instituti Demokratik Amerikan (NDI) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 5 (pesë) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Instituti Demokratik Amerikan (NDI) është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor

Ambasada Italiane i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 4 (katër) vëzhgues afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyes, si dhe zonat

e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Italiane është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Amerikane i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 14 (katërbëdhjetë) vëzhgues afatshkurtër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Amerikane është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Sllovene i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyes, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Sllovene është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S:

1. Akreditimin e 102 (njëqind e dy) përkthyesve të Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR të për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 10 (dhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 (katër) përkthyesve të Parlamentit Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



“Për shqyrtimin e kërkesave të Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR, të Institutit Demokratik Amerikan, Parlamentit Evropian dhe Ambasadave Italiane, Amerikane, Sllovene, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

3. Akreditimin e 5 (pesë) vëzhguesve afatshkurtër të Institutit Demokratik Amerikan (NDI) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve të Ambasadës Italiane për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin e 14 (katërbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) përkthyesve të Ambasadës Amerikane për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 (dy) përkthyesve të Ambasadës Sllovene për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



“Për shqyrtimin e kërkesave të Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR, të Institutit Demokratik Amerikan, Parlamentit Europian dhe Ambasadave Italiane, Amerikane, Sllovene, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”